AGJENCIA E KËRKIMIT, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT

# MOBILITY HANDBOOK

## UDHËZUES PËR LËVIZSHMËRINË E PUNONJËSVE SHKENCORË

Tiranë, 2015

**PUBLIKUAR NGA:**

AGJENCIA E KERKIMIT, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT

**QËLLIMI I UDHËZUESIT:**

Qëllimi i këtij udhëzuesi është për t'i ardhur në ndihmë të gjitha Pikave Kombëtare të Kontakteve EURAXESS nëpër institucionet kërkimore shkencore Shqiptare, duke asistuar në këtë mënyrë të gjithë kërkuesit e huaj të interesuar për të punuar në këto institucione.

**PËRGATITI:**

Lidjana Shahinaj

*Përgjegjëse Sektori*
*Sektori i Programeve Kombëtare*
*Drejtoria e Programeve Kombëtare*

**DIZENJIMI GRAFIK:**

Nelda Kote

*Specialiste*
*Sektori i Programeve Kombëtare*
*Drejtoria e Programeve Kombëtare*

## Përmbajtja


1. Hyrja e të huajit në Shqipëri ..... 3

1.1. Si mund të hyjë një shtetas i huaj në shtetin Shqiptar? ..... 3

1.2. Ku dhe si mund të aplikohet për të marrë vizë për të hyrë në Shqipëri? ..... 5

1.3. Si mund të gjeni kontaktet dhe adresat e Përfaqësive të huaja në Shqipëri? ..... 5

1.4. Cilat janë kriteret për hyrjen, qëndrimin, daljen dhe kalimin transit në Shqipëri? ..... 5

1.5. Çfarë përfshin dhe si mund të paguhet garancia financiare për të hyrë në Shqipëri? ..... 6

2. Qëndrimi i të huajit në Shqipëri ..... 7

2.1. Leja e përkohshme e qëndrimit për motive punësimi. ..... 7

2.2. Çfarë është leja e qëndrimit për punonjës me kualifikim të lartë "Karta Blu AL"? ..... 7

2.3. Cila kategori e shtetasve të huaj nuk përfiton leje qëndrimi "Kartë Blu AL"? ..... 7

2.4. Si mund të pajiset një shtetas i huaj me leje qëndrimi për kërkim shkencor? ..... 8

2.5. Kush është dokumentacioni i nevojshëm për të gjitha llojet e lejeve të qëndrimit? ..... 8

2.6. Kush është dokumentacioni i nevojshëm për kërkim shkencor? ..... 9

3. Bashkimi familjar i të huajit me anëtaret e familjes. ..... 10

3.1. Si mund të realizohet bashkimi familjar i të huajit me anëtarët e familjes? ..... 10

3.2. Rregulla të përgjithshme për anëtarët e familjes së të huajit ..... 11

3.3. Punësimi i të huajve ..... 11

3.4. Cilat janë kushtet që duhet të plotësojnë shtetasit e huajt për të përfituar shtetësinë shqiptare? ..... 12

3.5. Cilat janë dokumentet që i huaji duhet të paraqesë për të fituar shtetësinë shqiptare? ..... 12

3.6. Cilat janë afatet proceduriale për shtetësinë shqiptare ? ..... 13

3.7. Ku depozitohet dhe nga kush depozitohet kërkesa për shtetësinë shqiptare? ..... 13

3.8. Si procedohet në rast se i huaji humbet dokumentet e tij? ..... 14

4. Lejet e drejtimit të automjeteve të shtetasve të huaj dhe njëvlefshmëria e tyre në Shqipëri. ..... 15

4.1. A është e mundur të pajiset me leje drejtimi automjeti një shtetas i huaj? ..... 15

4.2. Cilat janë dokumentat për konvertimin e lejeve të drejtimit lëshuar nga shtetet e huaja, në leje drejtimi shqiptare? ..... 16

5. Shërbimi i kujdesit shëndetësor për shtetasit e huaj ..... 17

5.1. Si është organizuar sistemi shëndetësor në Shqipëri? 17
5.2. Shërbimi spitalor në Republikën e Shqipërisë: 17
5.3. Cilat janë spitalet private dhe publike në Shqipëri? 18
5.3.1. Spitale Shtetërore në rrethe 18
5.3.2. Spitale shtetërore në Tiranë 21
5.3.3. Spitale private në Shqipëri 21
5.4. Cilat janë të drejtat e pacientit në Shqipëri? 23
5.5. A përfshihen shtetasit e huaj në Sigurimet shëndetësore të detyrueshme? 23
5.6. Si llogariten kontributet shëndetësore në Shqipëri? 23
5.7. Ku dhe si mund të paguhen kontributet? 24
5.8. Cilat janë afatet e pagesës së kontributeve? 24
5.9. Mbrojtja për shtetasit e huaj 24
6. Arsimimi 26
6.1. Regjistrimi i fëmijëve të shtetasve të huaj në klasat e arsimit të detyruar 26
6.2. Shkolla 9-vjeçare publike në Tiranë: 26
6.3. Shkolla 9-vjeçare jo publike në Tiranë: 28
6.4. Shkolla të mesme publike në Tiranë: 30
6.5. Shkolla të mesme jo publike në Tiranë: 31
6.6. Universitete shtetërore në Shqipëri 32
6.7. Universitete jo publike në Tiranë 38
6.8. Si realizohet njehësimi i diplomave të shkollës së mesme, për punësim ose vazhdim studimesh në institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri? 39
7. Tatimet 41
7.1. Kur lind detyrimi tatimor në Shqipëri? 41
7.2. Kur konsiderohen shtetasit rezidentë shqiptarë për qëllime tatimore? 41

## 1. Hyrja e të huajit në Shqipëri

### 1.1. Si mund të hyjë një shtetas i huaj në shtetin Shqiptar?

I. Shtetasit që mund të hyjnë në Republikën e Shqipërisë pa viza dhe dokumentet me të cilët duhet të jenë të pajisur:

| Shteti | Me pasaportë | Me kartë identiteti |
|---|---|---|
| Andora | + | |
| Argjentina | + | |
| Armenia* | + | |
| Australia | + | + |
| Austria | + | + |
| Azerbajxhan | + | |
| Belgjikë | + | + |
| Bosnja dhe Hercegovina | + | |
| Brazili | + | |
| Mbretëri e Bashkuar | + | + |
| Bullgaria | + | + |
| Danimarka | + | + |
| Estonia | + | + |
| Finlanda | + | + |
| Franca | + | + |
| Gjermania | + | + |
| Greqia | + | + |
| Hollanda | + | + |
| Hong Kong (Kina)* | + | + |
| Hungaria | + | + |
| Irlanda | + | + |
| Islanda | + | + |
| Italia | + | + |
| Izraeli | + | |
| Japonia | + | |
| Kanada | + | + |
| Kazakistani* | + | + |
| Kili | + | |
| Kosova | + | + |
| Kroacia | + | + |
| Letonia | + | + |
| Lichtenstein | + | + |
| Lituania | + | + |
| Luksemburgu | + | + |
| Malajsia | + | |

| | | |
|---|---|---|
| **Mal i Zi** | + | + |
| **Malta** | + | + |
| **Maqedonia** | + | + |
| **Monako** | + | + |
| **Norvegjia** | + | + |
| **Polonia** | + | + |
| **Portugalia** | + | + |
| **Qipro** | + | + |
| **Republika e Koresë** | + | + |
| **Republika Çeke** | + | + |
| **Rumania** | + | + |
| **San Marino** | + | + |
| **Vatikani – Selia e Shenjtë** | + | + |
| **Serbia** | + | |
| **Sh.B.A.** | + | |
| **Singapori** | + | + |
| **Sllovakia** | + | + |
| **Sllovenia** | + | + |
| **Spanja** | + | + |
| **Suedia** | + | + |
| **Taivani (Kinë)** | + | |
| **Turqia** | + | |
| **Ukraina** | + | |
| **Zelanda e Re** | + | + |
| **Zvicra** | + | + |
| **Emiratet e Bashkuara Arabe** | + | + |
| **Kuvajti** | + | + |

II. Qytetarët e shteteve si më poshtë hyjnë pa viza për shkak të liberalizimit të vizave të tyre me zonën Shengen:

| **Shtetet** | | | |
|---|---|---|---|
| **Antigua & Barbuda** | Honduras | Panama | Uruguaj |
| **Bahamas** | Kosta Rika | Paraguaj | Venezuela |
| **Barbados** | Mauritius | Salvador | Makao (Kinë) |
| **Brunei** | Meksika | Seychelles | Moldova |
| **Guatemala** | Nikaragua | St. Kitts dhe Nevis | |

III. Shtetasit e vendeve të treta të cilët :

a) kanë një vizë të vlefshme Shengen me shumë kalime, e cila është përdorur më parë në një nga vendet e zonës Shengen, ose kanë një leje të vlefshme qëndrimi në një nga vendet e zonës Shengen;
b) kanë një vizë me shumë kalime të SHBA-së apo Mbretërisë së Bashkuar, e cila është përdorur më parë në një nga këto vende, ose kanë leje qëndrimi të vlefshme në SHBA ose në Mbretërinë e Bashkuar.

* Në rast qëndrimi më shumë se 90 ditë gjatë një periudhe gjashtë-mujore, ata duhet të pajisen me vizë të tipit "D".

http://www.punetejashtme.gov.al/files/userfiles/Kush_mund_te_hyje_ne_Shqiperi_pa_viza_03.02.2015.pdf

http://www.punetejashtme.gov.al/files/userfiles/Ku_te_aplikojme_per_te_marre_vize_per_te_hyre_ne_Shqiperi.pdf

### 1.2. Ku dhe si mund të aplikohet për të marrë vizë për të hyrë në Shqipëri?

Në linkun si me poshte gjendet një informacion më i detajuar për vendin ku duhet të aplikohet për të marrë Vizë për të hyrë në Shqipëri:

http://www.punetejashtme.gov.al/files/userfiles/Ku_te_aplikojme_per_te_marre_vize_per_te_hyre_ne_Shqiperi.pdf

Ministria e Punëve të Jashtme të Shqipërise në faqen e saj zyrtare ka publikuar formularin ku mund të aplikohet pa pagesë për të marrë vizë.

http://www.punetejashtme.gov.al/files/userfiles/Aneksi_5_formulari_per_vize.pdf

### 1.3. Si mund të gjeni kontaktet dhe adresat e Përfaqësive të huaja në Shqipëri?

Në linkun si më poshtë gjendet Kontaktet dhe adresat Përfaqësive të huaja në Shqipëri:

http://www.punetejashtme.gov.al/files/userfiles/Diplomatic_list_March_2015.pdf

### 1.4. Cilat janë kriteret për hyrjen, qëndrimin, daljen dhe kalimin transit në Shqipëri?

Bazuar në "Ligjin për të huajt" Nr. 108/2013, neni 6, citojmë:

I huaji, i cili ka për qëllim të hyjë, të qëndrojë, të dalë, ose të kalojë transit në/nga Republika e Shqipërisë, me përjashtim të rasteve të azilkërkimit, si dhe kur me marrëveshje dy ose shumëpalëshe është përcaktuar ndryshe, duhet të paraqitet në pikën e kalimit kufitar, duke plotësuar kushtet si më poshtë:

a) të ketë një dokument udhëtimi të njohur nga Republika e Shqipërisë, me një afat vlefshmërie të paktën 3 muaj para datës së përfundimit të tij;

b) të jetë i pajisur me vizë hyrëse të vlefshme, nëse kërkohet, ose të jetë i pajisur me leje të vlefshme qëndrimi, të lëshuar nga autoriteti kompetent shqiptar, apo të lëshuar nga vende të tjera dhe të njohur nga Republika e Shqipërisë;
c) të mos përbëjë kërcënim për rendin dhe sigurinë publike, për sigurinë kombëtare, si dhe të mos cenojë marrëdhëniet ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë me shtete të tjera;
d) të mos ketë shënime në regjistrin elektronik kombëtar për të huajt që kufizojnë hyrjen e tij;
e) të mos përbëjë rrezik për shëndetin publik në Republikën e Shqipërisë;
f) të mos jetë debitor ndaj masave administrative të vëna ndaj tij, sipas dispozitave të këtij ligji;
g) mbi bazën e vlerësimit, rast pas rasti, të huajit mund t'i kërkohet paraqitja e dokumenteve të tjera shtesë, lloji i të cilave miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Personeli i organizatave ndërkombëtare, në kuadër të kryerjes së detyrave dhe misioneve të ngarkuara prej tyre, mund të hyjnë, të qëndrojnë, të kalojnë transit dhe të dalin nga Republika e Shqipërisë duke përdorur leje kalimi të lëshuar prej tyre ose ndonjë dokument tjetër, që është i vlefshëm në kuadër të marrëveshjeve ndërkombëtare, të njohura nga Republika e Shqipërisë.

### 1.5. Çfarë përfshin dhe si mund të paguhet garancia financiare për të hyrë në Shqipëri?

Ne bazë të nenit 13 të "Ligjit per të huajt" citojmë simë poshtë lidhur me garancinë financiare për të huajt:

1. I huaji, i cili aplikon për vizë ose për leje qëndrimi, depoziton një shumë të caktuar të hollash në llogari bankare, me qëllim garancie financiare.
2. Garanci financiare është shuma e nevojshme financiare, që depozitohet nga vetë i huaji ose nga garanti për llogari të të huajit, me qëllim që të mbulohen shpenzimet e jetesës dhe pasojat e një dëmi, që mund të shkaktohet nga një veprim apo mosveprim i të huajit, në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, për një periudhë të caktuar të qëndrimit të tij në Republikën e Shqipërisë.
3. Garancia financiare për llogari të të huajit mund të depozitohet dhe nga ftuesi i tij në Republikën e Shqipërisë.
4. Kufiri i garancisë financiare, si dhe procedurat e depozitimit dhe kthimit të garancisë financiare, caktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Punëve të Jashtme,sipas standardeve mesatare të jetesës, në përputhje me kriteret dhe procedurat e parashikuara në legjislacionin shqiptar.

## 2. Qëndrimi i të huajit në Shqipëri

### 2.1. Leja e përkohshme e qëndrimit për motive punësimi.

Neni 39 i "Ligjit për të huajt" për lejen e përkohshme të qëndrimit për personat e huaj të punësuar në Shqipëri parashikon procedurën si më poshtë:

1. Autoriteti përgjegjës për kufirin dhe migracionin pajis të huajin me "leje qëndrimi si person i punësuar", kur përmbush kushtet dhe vlerësohet se dokumentacioni i paraqitur plotëson kërkesat për marrjen e një "lejeje qëndrimi si person i punësuar".
2. Leja e qëndrimit si person i punësuar" jepet në përputhje me lejen e punës.
3. Pas lëshimit të "lejes së qëndrimit si person i punësuar" mbajtësi i saj është i detyruar të njoftojë autoritetet përgjegjëse për çdo ndryshim të kushteve, mbi të cilat është lëshuar leja, në rast se ndryshimi lidhet me:
   a) emrin dhe adresën e vendit të punës, si dhe adresën e tij të punës e të banimit;
   b) kontratën e punës së vlefshme.
4. Për shtetasit e Bashkimit Europian/zonës Shengen, si dhe ata të parashikuar me marrëveshje ndërkombëtare, nuk zbatohen dispozitat e pikave 2 dhe 3 të këtij neni.

### 2.2. Çfarë është leja e qëndrimit për punonjës me kualifikim të lartë "Karta Blu AL"?

Në bazë të nenit 44 të ligjit Nr.108/2013 "Për të huajt" citojmë:

1 Autoriteti përgjegjës për kufirin dhe migracionin pajis të huajin me leje qëndrimi "Kartë Blu AL" për punë me kualifikim të lartë vetëm nëse është pajisur me leje pune të posaçme për punonjës të kualifikuar dhe kur përmbush kushtet për marrjen e një lejeje qëndrimi "Kartë Blu AL".

2 Leja e qëndrimit "Kartë Blu AL" për punë me kualifikim të lartë lëshohet për një afat 2-vjeçar dhe mund të ripërtërihet për një periudhe 3-vjeçare. Në rast se leja e punës për punonjësin me kualifikim të lartë është lëshuar për një kohëzgjatje më pak se 2 vjet, leja e qëndrimit "Kartë Blu AL" lëshohet për kohën e lejes së punës, plus 3 muaj.

3 Mbajtësi i lejes së qëndrimit "Kartë Blu AL" njofton autoritetet përgjegjëse për ndryshimet në marrëdhëniet e tij/saj të punësimit.

4 Shtetasit e vendeve të Bashkimit Europian dhe zonës Shengen përjashtohen nga detyrimi i pajisjes me leje pune.

### 2.3. Cila kategori e shtetasve të huaj nuk përfiton leje qëndrimi "Kartë Blu AL"?

Bazuar në Nenin 45, të "Ligjit për të huajt", nuk përfitojnë leje qëndrimi për punë me kualifikim të lartë "Kartë Blu AL" të huajt, të cilët:

a) qëndrojnë në Republikën e Shqipërisë si kërkues për mbrojtje ndërkombëtare apo sipas skemave të mbrojtjes së përkohshme;

b) janë refugjatë apo kanë paraqitur kërkesë për të marrë statusin e refugjatit dhe kjo kërkesë e tyre ende nuk ka marrë formën e një vendimi përfundimtar;
c) kanë paraqitur kërkesë pranë autoriteteve të kufirit dhe migracionit në Republikën e Shqipërisë për t'u pajisur apo janë pajisur me leje qëndrimi si kërkues/studiues, me qëllim kryerjen e një projekti studimor/kërkimor;
d) gëzojnë statusin e banorit afatgjatë dhe ushtrojnë të drejtën e tyre për të qëndruar në Republikën e Shqipërisë, me qëllim ushtrimin e një aktiviteti ekonomik, si punëmarrës apo i vetëpunësuar;
e) hyjnë në Republikën e Shqipërisë, sipas angazhimeve të parashikuara në marrëveshjet ndërkombëtare të njohura nga Republika e Shqipërisë, që lehtësojnë hyrjen dhe qëndrimin e përkohshëm të disa kategorive tregtare dhe personave fizikë, të lidhur me investime;
f) për arsye ligjore u është pezulluar dëbimi.

### 2.4. Si mund të pajiset një shtetas i huaj me leje qëndrimi për kërkim shkencor?

Neni 51 i ligjit Nr.108/2013 "Për të huajt" përcakton:

1. Autoriteti përgjegjës për kufirin dhe migracionin pajis me "leje qëndrimi për kërkim shkencor" me afat jo më shumë se 1 vit, të huajin i cili ka lidhur një marrëveshje me një institucion shqiptar për këtë qëllim dhe që plotëson kushtet e përgjithshme për pajisje me leje qëndrimi, sipas nenit 37 të këtij ligji;
2. Ky nen nuk zbatohet për shtetasit e vendeve të Bashkimit Europian dhe zonës Shengen, si dhe rasteve kur zbatohet një regjim i posaçëm, i parashikuar me marrëveshje ndërkombëtare.

### 2.5. Kush është dokumentacioni i nevojshëm për të gjitha llojet e lejeve të qëndrimit?

Për t'u pajisur me leje qëndrimi, i huaji depoziton këto dokumente:

a) Formularin e aplikimit për leje qëndrimi përkatësisht të plotësuar dhe të nënshkruar nga aplikuesi;
b) Dy fotografi të aplikuesit, te bëra jo më përpara se 6 (gjashtë) muaj nga data e aplikimit, me përmasa 47mm X 36 mm, të marra në plan me sfond të bardhë, të fokusuara dukshëm dhe qartë. Fotografia duhet të tregojë personin përballë, me qëndrim neutral e sytë të hapur dukshëm;
c) Fotokopjen e dokumentit të vlefshëm të udhëtimit me të cilin i huaji ka hyrë në Republikën e Shqipërisë, si dhe fotokopjen e faqeve me shënime etj.;
d) Dokumente që provojnë akomodim të përshtatshëm në Shqipëri. Kontratën e blerjes ose të marrjes me qira te banesës në përputhje me standardet e banimit në Shqipëri

ose çdo dokument tjeter që provon strehimin e garantuar në Republikën e Shqipërisë;

e) Vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
f) Dëshminë e sigurimit shëndetësor për në Shqipëri.

Më tepër informacion mund të gjeni ne linkun:

http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2013/PDF-2013/110-2013.pdf

## 2.6. Kush është dokumentacioni i nevojshëm për kërkim shkencor?

*Për kërkim shkencor paraqiten:*

A. Certifikata e regjistrimit në punë në përputhje me nenin 73 të ligjit nr.108/2013, "Për të huajt";
B. Fotokopja e marrëveshjes së nënshkruar me organizatën kërkimore-shkencore apo institucionin e edukimit të lartë në Shqipëri;
C. Dëshmia e burimeve financiare të mjaftueshme për jetese gjate qëndrimit në Shqipëri për periudhën e kërkuar.

*Për më tepër informacion:*

http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2013/PDF-2013/110-2013.pdf

*Për studentë dhe nxënës shkolle paraqiten:*

A. Dokumenti i pranimit nga një institucion arsimor në Shqipëri;
B. Dëshmia e burimeve të mjaftueshme financiare për jetesë gjatë qëndrimit në Shqipëri për periudhën e kërkuar;
C. Dëshmia e njohjes së gjuhës.

## 3. Bashkimi familjar i të huajit me anëtaret e familjes.

### 3.1. Si mund të realizohet bashkimi familjar i të huajit me anëtarët e familjes?

Neni 56, i "Ligjit për të huajt", parashikon si më poshtë:

1. I huaji, i pajisur me leje qëndrimi në Republikën e Shqipërisë, mund të bëjë kërkesë pranë autoritetit përgjegjës vendor për kufirin dhe migracionin për bashkim familjar, nëse plotëson kushtet e mëposhtme:
   a) anëtarët e familjes së tij ndodhen jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Përjashtimisht, për arsye humanitare, sipas kritereve të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave dhe procedurave të miratuara me udhëzim të Ministrit të Brendshëm, kërkesa mund të bëhet dhe kur anëtari/ët e familjes ndodhen në territorin e Republikës së Shqipërisë;
   b) është i pajisur me leje qëndrimi me afat së paku 1-vjeçar në Republikën e Shqipërisë dhe ka mundësi ta ripërtërijë lejen, në përputhje me dispozitat përkatëse të këtij ligji;
   c) siguron strehim në kushte normale jetese, sipas standardeve të përgjithshme mbi shëndetin dhe sigurinë;
   d) ka sigurim shëndetësor për vete dhe familjen e tij, për të cilët kërkon bashkimin familjar;
   e) garanton burime të qëndrueshme të të ardhurave financiare për të mbajtur veten dhe familjen e tij, pa iu drejtuar skemës së ndihmës ekonomike;
   f) paraqet dokumentacionin, sipas përcaktimeve të vendimit të Këshillit të Ministrave.
2. Leja e qëndrimit për bashkim familjar jepet për herë të parë për një periudhë kohe 1-vjeçare, e ripërtëritshme, nëse nuk është përcaktuar ndryshe në marrëveshje apo në këtë ligj.
3. Leja e qëndrimit për bashkim familjar, në rast se plotësohen kushtet e kërkuara, në këtë ligj dhe kriteret e miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave, ripërtërihet sipas përcaktimeve në nenin 38 të këtij ligji.
4. Fëmijët e pamartuar, si dhe paraardhësit e kërkuesit (ftuesit), që janë objektivisht të pamundur të plotësojnë nevojat e tyre, për arsye të gjendjes shëndetësore, mund të pajisen me leje qëndrimi si raste përjashtimore.
5. Fëmijët e pamartuar mund të aplikojnë për leje qëndrimi për bashkim familjar deri në moshën 30 vjeç, me kusht që i huaji kërkues (ftuesi) të garantojë mbulimin e të gjitha shpenzimeve të jetesës për ta.
6. Në rast se refuzohet dhënia e lejes së qëndrimit për bashkim familjar, i huaji ose familjarët e tij kanë të drejtën e ankimit, sipas legjislacionit në fuqi.

"Ligjit për të huajt": http://www.punetebrendshme.gov.al/files/documents_files/13-11-14-04-05-08ligji_per_te_Huajt.pdf

### 3.2. Rregulla të përgjithshme për anëtarët e familjes së të huajit

Neni 69 i "Ligjit për të huajt", parashikon këto rregulla:

1 I mituri, i cili ka hyrë në Republikën e Shqipërisë për shkak të bashkimit familjar, kur mbush moshën madhore, ka të drejtë të aplikojë në mënyrë të pavarur nga anëtarët e familjes, për t'u pajisur me leje qëndrimi.
2 Bashkëjetuesit trajtohen njëlloj për aq sa është e zbatueshme, si bashkëshortët, lidhur me bashkimin familjar.
3 I huaji, në rast të martesave poligame, ka të drejtë të kërkojë bashkim familjar me njërën nga bashkëshortet, si dhe fëmijët e lindur nga kjo bashkëshorte.
4 Të huajt, të pajisur me leje qëndrimi, të cilëve u ka lindur një fëmijë në Republikën e Shqipërisë, njoftojnë autoritetin përgjegjës vendor për kufirin dhe migracionin për aktin e lindjes brenda 30 ditëve dhe ky i fundit u lëshon leje të përkohshme qëndrimi për fëmijën.

### 3.3. Punësimi i të huajve

Në bazë të Nenit 71 të "Ligjit për të huajt":

1. I huaji mund të punësohet në Republikën e Shqipërisë duke u pajisur me leje pune, apo me certifikatë regjistrimi pune, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj, me marrëveshje ndërkombëtare të njohura nga Republika e Shqipërisë apo qëndrim të njëanshëm të shprehur me vendim të Këshillit të Ministrave.
2. Veprimet paraprake për hapjen e një aktiviteti biznesi apo shërbimesh nuk konsiderohen si punë.
3. Kërkesa për leje pune për një të huaj mund të bëhet nga vetë i huaji, me qëndrim të ligjshëm në Republikën e Shqipërisë, ose nga punëdhënësi.
4. Punëdhënësi ka të drejtë të bëjë kërkesë për leje pune për të huajin vetëm pasi ka publikuar për 4 javë vendin e lirë të punës, si dhe brenda kuotave të miratuara, ose për kategoritë e përcaktuara në nenin 83 të këtij ligji.
5. Shqyrtimi i kërkesës dhe lëshimi i lejes së punës, kur plotësohen kriteret e kërkuara nga legjislacioni në fuqi, bëhet brenda 30 ditëve nga dita e aplikimit.
6. Punëdhënësi nuk mund të punësojë një të huaj që qëndron në mënyrë të parregullt në Republikën e Shqipërisë.
7. Kur punëdhënësi punëson një të huaj, duhet të njoftojë zyrën përkatëse të punësimit dhe autoritetin përgjegjës rajonal për kufirin dhe migracionin brenda 8 ditëve pas fillimit të punës së të huajit.
8. Kriteret, procedurat dhe dokumentacioni për pajisjen e të huajve me leje pune apo me certifikatë regjistrimi, sipas këtij ligji, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
9. Shtetasit e vendeve të Bashkimit Europian dhe zonës Shengen përjashtohen nga përcaktimet e pikës 1 të këtij neni dhe gëzojnë të drejta të barabarta me shtetasit shqiptarë në fushën e punësimit dhe të vetëpunësimit.

### 3.4. Cilat janë kushtet që duhet të plotësojnë shtetasit e huajt për të përfituar shtetësinë shqiptare?

1. Të ketë mbushur moshën 18 vjeç. Llogaritja bëhet në ditën e bërjes së kërkeses
2. Të ketë banuar ligjërisht në territorin e Republikës së Shqipërisë, në mënyrë të vazhdueshme, për jo më pak se 5 vjet.
3. Të ketë banesë dhe të disponojë të ardhura të mjaftueshme.
4. Të mos ketë qenë ndonjëherë i dënuar (në Republikën e Shqipërisë ose në ndonjë vend tjetër) për vepra penale, për të cilat ligji parashikon dënime me jo më pak se 3 vjet heqje lirie. Përjashtime nga ky rregull bëhen në rastet kur vlerësohet se dënimi është dhënë për motive politike.
5. Të ketë njohuri, të paktën fillestare, të gjuhës shqipe.
6. Dhënia e shtetësisë shqiptare të mos prekë sigurimin dhe mbrojtjen e Republikës së Shqipërisë.

Në website e Ministrisë së Punëve të Brendëshme mund të gjendet informacioni i nevojshëm për të fituar shtetësinë Shqiptare:

http://www.punetebrendshme.gov.al/files/programs_files/14-09-10-10-12-20shtetesia_shqiptare.pdf

### 3.5. Cilat janë dokumentet që i huaji duhet të paraqesë për të fituar shtetësinë shqiptare?

- Me natyralizim :

- Kërkesa e shtetasit të huaj drejtuar Presidentit të Republikës.Kërkesa tëpërmbajë identitetin e plotë të kërkuesit (emër mbiemër, datëlindje, vendlindje, shtetësinë), adresën e saktë të vendbanimit të tij tëpërhershëm dhe adresën ku pret informim për ecurinë e aplikimit të tij, arsyet e kërkesës për fitimin e shtetësisë shqiptare. Kërkesa nënshkruhet me emër, mbiemër e firmë nga kërkuesi;
- Mendimi me shkrim të nëpunësit që pranon dokumentet për nivelin e njohurive të gjuhës shqipe;
- Çertifikata e lindjes;
- Lejeqendrimi në Repulikën e Shqipërisë, sipas kritereve të ligjit për shtetësinë (fotokopje e noteruar), nëse banon në Shqipëri;
- Akti i pronësisë së banesës ose kontrata e zënies me qera të banesës (fotokopje e noteruar);
- Kontratë pune për të punësuarit ose vertetim nga Zyra e tatimeve për të vetpunësuarit ose investitorët (fotokopje e noteruar);
- Dokumente që vërtetojnë disponimin e mjeteve financiare tëmjaftueshme për jetesë si garanci bankare, libreze kursimi, vërtetime zyrtare të ardhurash (fotokopje e noteruar);

- Dëshmi penaliteti e marrë në vendin e origjinës dhe në vendin kukërkuesi ka patur qendrim legal për gjashtë muajt e fundit;
- Dokument që vërteton qenien azilant, nëse është i tille (Fotokopje enoteruar);
- Fotografi e aplikantit, copë tre (Në rast se ka fëmije nën 14 vjeç, fotografi për secilin prej tyre).
- Çertifikatë (kur është e nevojshme) për të vërtetuar origjinën shqiptare tëkërkuesit, deri në dy shkallë, qofte dhe nga njëri prind.

http://www.punetebrendshme.gov.al/files/programs_files/14-09-10-10-12-20shtetesia_shqiptare.pdf

### 3.6. Cilat janë afatet proceduriale për shtetësinë shqiptare ?

Ministria e Punëve të Brendëshme brenda **6 muajve** nga data e paraqitjes së kërkesës për shtetësinëshqiptare vendos për ***paraqitjen ose jo*** të kërkesës pranë Presidentit të Republikës. Vendimi iMinistrisë sëPunëve të Brendëshme për paraqitjen ose jo të kërkesës pranë Presidentittë Republikës i bëhet i njohur të interesuarve, të cilët nëse nuk janë dakort me përmabjtjen e vendimit mund të ngrenë padi në gjykatën e rrethit Tiranë. Presidenti i Republikës, brenda **3 muajve** nga paraqitja e kërkesës sëMinistrisë së Punëve të Brendëshme, nxjerr dekretin përkatës.

http://www.punetebrendshme.gov.al/files/programs_files/14-09-10-10-12-20shtetesia_shqiptare.pdf

### 3.7. Ku depozitohet dhe nga kush depozitohet kërkesa për shtetësinë shqiptare?

Në komisariat të policisë vendore ku aplikuesi është me banim të përkohshem ose katë regjistruar gjendjen civile.

Për shtetasit e huaj, apo shqiptarë, që banojnë jashtë shtetit aplikimi mund të bëhetedhe në përfaqësinë diplomatike ose konsullore të Republikës së Shqipërisë në shtetin

ku ai është rezident ose në përfaqësinë që mbulon shërbimet konsullore për vendin kuai është rezident.

http://www.punetebrendshme.gov.al/files/programs_files/14-09-10-10-12-20shtetesia_shqiptare.pdf

*Kërkesa për shtetësinë shqiptare depozitohet nga :*

a) Kërkuesi për shtetësinë shqiptare drejtpërdrejt;
b) Nga përfaqësuesi i tij me prokurë të posaçme.

Nuk ka asnjë pengesë ligjore që një shtetas shqiptar me rezidencë në një vend të huaj të dorëzojë kërkesën për shtetësinë shqiptare në komisariatin e policisë vendore ku ka të

regjistruar gjendjen e tij civile, nëse qoftë dhe rastesisht gjendet fizikisht në Republikën e Shqipërisë.

### 3.8. Si procedohet në rast se i huaji humbet dokumentet e tij?

Neni 19 i "Ligjit për të huajt" parashikon kryerjen e procedurave si më poshtë:

Humbja/dëmtimi i dokumenteve të lëshuara

1. I huaji raporton menjëherë humbjen ose dëmtimin e letërnjoftimit, dokumentit të udhëtimit, lejes së kalimit ose të lejes së qëndrimit tek autoriteti përgjegjës vendor për kufirin dhe migracionin, ku ka vendqëndrimin e përkohshëm ose të përhershëm. Në këtë rast, të huajit i lëshohet një dokument i përkohshëm.
2. Dokumenti i lëshuar, sipas pikës 1 të këtij neni, është i vlefshëm deri në marrjen e letërnjoftimit, dokumentit të ri të udhëtimit ose të lejes së qëndrimit të humbur, dokument i cili i kthehet në këtë rast nga autoriteti përgjegjës lëshues. Formati i dokumentit të lëshuar, sipas kësaj pike, miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.
3. Procedurat dhe autoritetet përgjegjëse për shpalljen në kërkim të dokumentit të udhëtimit ose lejes së qëndrimit të të huajit miratohen me udhëzim të Ministrit të Brendshëm.

# 4. Lejet e drejtimit të automjeteve të shtetasve të huaj dhe njëvlefshmëria e tyre në Shqipëri.

## 4.1. A është e mundur të pajiset me leje drejtimi automjeti një shtetas i huaj?

Dokumentat për pajisjen me leje drejtimi për herë të parë kategoria A ose B për shtetasit e huaj me leje qëndrimi në Shqipëri:

a. Autorizimi Model DL/T e DL/P të plotësuar nga Autoshkolla.
b. Dokument identiteti (fotokopje të pasaportës të përkthyer në gjuhën shqipe, të legalizuar nga noteri).
c. Fotokopje të lejes së qëndrimit të lëshuar nga organet e policisë së shtetit, të legalizuar nga noteri, me afat skadence, jo më përpara se afati i vlefshmerisë së autorizimit.
d. Çertifikatë mjekësore me fotografi, të lëshuar me datë jo me përpara se 3 (tre) muaj, nga data e pajisjes me autorizim.
e. Dokumentin e përcaktimit të Grupit të Gjakut dhe Rehzusin.
f. Fotografi me ngjyra, copë 4 (katër).
g. Fotokopjen e dëshmisë për kryerjen e kursit të ndihmës së shpejtë mjeksore pranë Kryqit të Kuq Shqiptar.
h. Dokumentet përkatëse për shlyerjen e detyrimeve financiare:
    - Tarifa për shërbimin e kryer nga DPSHTRR 2.200 lekë;
    - Tarifa e pajisjes me leje drejtimi për buxhetin e shtetit:
        i. KategoriaA,3.000lekë;
        ii. Kategoria B,4.500lekë.
    - Vlera e kartonit të lejes së drejtimit 3.500 lekë.

<u>Për shtetasit e huaj me status diplomatik në Shqipëri:</u>

1. Autorizimi Model DL/T e DL/P të plotësuar nga Autoshkolla;
2. Fotokopje të kartës së legjitimitetit të lëshuar nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe fotokopje të pasaportës të legalizuar nga ambasada;
3. Çertifikatë mjekësore me fotografi, të lëshuar me datë jo me përpara se 3 (tre) muaj, nga data e pajisjes me autorizim;
4. Dokumentin e përcaktimit të Grupit të Gjakut dhe Rehzusin;
5. Fotografi me ngjyra, copë 4 (katër);
6. Fotokopjen e dëshmisë për kryerjen e kursit të ndihmës së shpejtë mjeksore prane Kryqit të Kuq Shqiptar;
7. Dokumentet përkatëse për shlyerjen e detyrimeve financiare;
8. Dokumentet përkatëse për shlyerjen e detyrimeve financiare.
    a. Tarifa për shërbimin e kryer nga DPSHTRR 2.200 lekë
    b. Tarifa e pajisjes me leje drejtimi për buxhetin e shtetit

i. Kategoria A, 3.000 lekë,
ii. Kategoria B, 4.500 lekë.

c. Vlera e kartonit të lejes së drejtimit 3.500 lekë

http://www.dpshtrr.gov.al/sherbimet/per-drejtuesit-e-mjeteve/lejet-e-drejtimit/sherbimet/163-per-leje-drejtimi

### 4.2. Cilat janë dokumentat për konvertimin e lejeve të drejtimit lëshuar nga shtetet e huaja, në leje drejtimi shqiptare?

a. Kërkesë e aplikantit.
b. Leje e drejtimit origjinale dhe fotokopje ( pa skaduar afati i vlefshmerisë ), të lëshuar nga shteti përkatës, të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të legalizuar nga noteri ( orgjinali i rikthehet deri në momentin e njehsimit ).
c. Dokument identiteti (letëer njoftimi elektronik), ndërsa për shtetasit e huaj, fotokopje të pasaportës, të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të legalizuar nga noteri.
d. Vërtetim banimi të lëshuar nga organet e pushtetit vendor, ndërsa për shtetasit e huaj, fotokopje të lejes së qëndrimit të lëshuar nga organet e policisë së shtetit, të legalizuar nga noteri.
e. Çertifikatë mjekësore me fotografi, të lëshuar me datë jo më parë se 3 (tre) muaj nga data e paraqitjes së kërkesës.
f. Dokumentin e përcaktimit të Grupit të Gjakut dhe Rehzusin.
g. Fotografi me ngjyra cope 4(katër).
h. Dokumenti përkatës për shlyerjen e detyrimeve financiare.
   i. Vlera e kartonit te lejes se drejtimit 3.500 leke.

* Konvertohen vetëm lejet e drejtimit të lëshuara nga shtete që bëjnë pjesë në EU dhe shtete me të cilat kemi marrëveshje. Në momentin e njehsimit, tërhiqet leja e drejtimit në origjinal, e cila i dërgohet zyrtarisht shtetit që e ka lëshuar.

## 5. Shërbimi i kujdesit shëndetësor për shtetasit e huaj

Ligj Nr.10 107, Datë 30.3.2009, neni 37

1. Shërbimi i kujdesit shëndetësor, që ofrohet në institucionet e kujdesit shëndetësor për shtetasit e huaj, që banojnë në Republikën e Shqipërisë, bëhet në bazë të marrëveshjeve përkatëse ndërkombëtare ose në bazë të parimit të reciprocitetit.
2. Në mungesë të një marrëveshjeje ndërkombëtare apo të kushteve ku zbatohet parimi i reciprocitetit, shtetasit e huaj përfitojnë shërbimet e kujdesit shëndetësor, në bazë të dispozitave të këtij ligji dhe të ligjit të financimit të kujdesit shëndetësor.
3. Shtetasit e huaj, që kanë nevojë për kujdes shëndetësor, në kushtet e urgjencës mjekësore, marrin kujdes shëndetësor dhe në kushte të barabarta me ato që zbatohen për shtetasit e Republikës së Shqipërisë.

### 5.1. Si është organizuar sistemi shëndetësor në Shqipëri?

Sistemi Shëndetësor në Shqipëri është kryesisht publik. Shteti siguron pjesën më të madhe të shërbimeve që i ofrohen popullatës si në fushën e promocionit, parandalimit, diagnostikimit dhe kurimit. Sektori privat është akoma në hapat e para dhe mbulon pjesën më të madhe të shërbimit farmaceutik, shërbimit stomatologjik dhe disa klinika diagnostikuese specialitetesh të cilat janë përqëndruar kryesisht në Tiranë.

Në sektorin publik rolin e liderit e luan Ministria e Shëndetësisë e cila është hartuese dhe përgjegjëse për politikat dhe strategjitë e sistemit shëndetësor, për rregullimin e tij si dhe për koordinimin e të gjithë aktorëve brenda dhe jashtë sistemit.

Shërbimi shëndetësor diagnostikues dhe kurues është i organizuar në tre nivele: shërbimi parësor, shërbimi spitalor dytësor, dhe spitalor terciar.

Shërbimet e shëndetit publik dhe promocionit ofrohen në kuadrin e shëndetit parësor dhe mbështeten dhe mbikqyren nga ISHP

Krahas këtyre ofrojnë shërbimet e tyre edhe një sërë institucionesh nacionale si Qendra Kombetare e Transfuzionit të Gjakut, Qendra Kombetare e Mirërritjes, Zhvillimit dhe Rehabilitimit të Femijës, Klinika Stomatologjike Universitare, etj.

Në mbështetje të institucioneve shëndetësore funksionojne edhe Qendra Kombetare e Inxhinierise Biomjekesore, Qendra Kombëtare e Kontrollit të Barnave dhe Qendra Kombëtare e Cilësisë Sigurisë dhe Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore.

http://www.shendetesia.gov.al/al/ministria/organizimi-i-sistemit-shendetesor

### 5.2. Shërbimi spitalor në Republikën e Shqipërisë:

Shërbimi spitalor në Republikën e Shqipërisë është publik dhe jopublik, i përgjithshëm dhe i specializuar.

Spitalet publike dhe jopublike janë të detyruara të shtrojnë e t'i japin ndihmë mjekësore shtetasve shqiptarë dhe të huaj, të siguruar ose jo, që kanë nevojë për shërbim spitalor urgjent për çfarëdo sëmundje ose aksident.

Dokumentet e duhura të shpenzimeve për ndihmën e dhënë plotësohen pas shtrimit.

Spitalet detyrohen të zbatojnë të drejtat e të sëmurëve të shtruar, sipas "Kartës së të drejtave të pacientit", të pranuar nga Organizata Botërore e Shëndetësisë.

Ligj. Nr. 9106, datë 17.7.2003

## 5.3. Cilat janë spitalet private dhe publike në Shqipëri?

### 5.3.1. Spitale Shtetërore në rrethe

| Emri i spitalit | Adresa/ Kontakti |
|---|---|
| **Spitali Rajonal Shkodër** | Lagjia "Skënderbeg", Rruga "Llukan Heqimi", 4002 Shkodër<br>Tel: 022247289 |
| **Spitali Rajonal Kukës** | Lagjia Nr.7, Kukës |
| **Spitali Rajonal Lezhë** | Lagjia "Varosh", Lezhë<br>Tel 0 215 24485 |
| **Spitali Rajonal Dibër** | Dibër, Albania<br>Tel: 0218 2072 |
| **Spitali Rajonal Elbasan** | Lagjia "Haxhijas", Elbasan<br>Tel: 054 258644<br>Fax: 054 258644<br>Web: http://www.sre.gov.all<br>E-mail: info@spitalirajonalelbasan.com |
| **Spitali Rajonal Korçë** | Bulevardi "Fan Noli 98", Korçë<br>Tel Drejtori/Sekretaria : 082 242 755<br>Tel Urgjenca :082242555/082242972<br>Web: http://www.srk.gov.al<br>E-mail: spitali_korce@yahoo.com |
| **Spitali Rajonal Gjirokastër** | Gjirokastër<br>Tel: 0846 3768 |

| | |
|---|---|
| **Spitali Rajonal Fier** | Lagjia "1 Maj", Rruga "Cameria", Fier<br>Tel: 034 22 021<br>Tel/Fax: 0342 22761 |
| **Spitali Rajonal Vlorë** | Lagjia " Partizani", Vlorë<br>Tel: 033 22 657<br>Tel Urgjenca: 033 224 151<br>033 224 336<br>033 222 631<br>Web: http://www.spitalivlore.com<br>E-mail:<br>Drejtoria_e_Spitalit_Rajonal_Vlore@hotmail.com |
| **Spitali Rajonal Durrës** | Lagjia 18, Rruga "A.Goga", Durrës<br>Tel/Fax: 052 2221 58 / 052 223358<br>Tel Urgjenca: 052 222 222 / 127<br>Web: http://www.srd.gov.al<br>Email:<br>Spitali Rajonal Durrës: info@srd.gov.al<br>Sekretaria S.R.D: sekretaria@srd.gov.al<br>Sektori Juridik S.R.D: sek.juridik@srd.gov.al |
| **Spitali Rajonal Berat** | Lagjia "Kushtrim", Berat<br>Tel: 03234237<br>Tel: 032 34 222 |
| **Spitali Rajonal Lushnje** | Lagjia "Xhevdet Nepravishta", Lushnje<br>Tel 035 222131<br>Tel: 035 222 68 |
| **Spitali Kurbin (Laç)** | Kurbin<br>Tel.+ 053 2622/04 |
| **Spitali Tropojë** | Tropojë<br>Tel Drejtoria e Spitalit : 0213 2200<br>Tel Urgjenca : 0213 2222<br>Web: http://spitalitropoje.gov.al<br>E-mail: spitalitropoj@hotmail.com |
| **Spitali Burrel (Mat)** | Lagjia "Drita", Burrel<br>Tel.021922685 |
| **Spitali Librazhd** | Librazhd<br>Tel: 0514 22 22 |
| **Spitali Peqin** | Lagja "Teqja", Peqin<br>Tel: 0512 23.24 |

| | |
|---|---|
| **Spitali Pogradec** | Pogradec<br>Tel Urgjenca: 08322614<br>Web: http://www.spitalipogradec.gov.al<br>Email: info@spitalipogradec.gov.al |
| **Spitali Devoll** | Devoll<br>Tel/Fax. Drejtoria: 0811 23330<br>Tel. Urgjenca: 0811 22017<br>Tel. Recepsioni: 081123327<br>Web: http://www.spitalidevoll.gov.al<br>E-mail: info@spitalidevoll.gov.al |
| **Spitali Sarandë** | Lagja 3, Rruga"Onhezmi", Sarandë |
| **Spitali Përmet** | Përmet<br>Tel:0813 69 / 224 11 |
| **Spitali Mallakastër** | Mallakastër |
| **Spitali Kavajë** | Kavajë<br>Tel: 0554 28 28 |
| **Spitali Kuçovë** | Kuçovë<br>Tel.: 0311 27.30 |
| **Spitali Kolonjë (Ersekë)** | Ersekë<br>Tel: 0812 21.17 |
| **Spitali Psikiatrik Vlorë** | Lagjia "10 Korriku", Rruga "Perlat Rexhepi", Vlorë<br>Tel: 229 897/033 23 108<br>Web: http://spvlore.gov.al/<br>E-mail: info@spvlore.gov.al |
| **Spitali Psikiatrik Elbasan** | Lagjia "Haxhias", Elbasan<br>Tel/Fax. 355 542 41545<br>Tel Financa: 0545 2 44 168<br>Tel Psikologu: 0545 2 44 370<br>Web: http://www.spe.gov.al/ |

### 5.3.2. Spitale shtetërore në Tiranë

| Emri i spitalit | Adresa/ Kontakti |
|---|---|
| **Qëndra Spitalore Universitare "Nënë Tereza"** | Rruga e Dibrës Nr. 372, Tiranë<br>Tel. 042 362627,<br>Fax. 042 363644<br>Web: http://www.qsu.gov.al/ |
| **Materniteti "Koço Gliozheni"** | Tiranë<br>Tel: 04 2370 796 |
| **Materniteti "Mbretëresha Geraldinë"** | Bulevardi "Zogu i 1-rë", Tiranë<br>Tel. 04 227315<br>Fax. 04 223504<br>Web: http://www.suogjgeraldine.gov.al<br>E-mail: info@suogjgeraldine.gov.al |
| **Spitali Universitar i Sëmundjeve te Mushkërive (Sanatorium)** | Rruga e Elbasanit, Sauk, Tiranë<br>Tel: Recepsioni: 04 22467793<br>Urgjenca: 04 22467793<br>Kërko Doktorin: 04 22467793<br>Administrata: 0422467793<br>Web: http://www.sushefqetndroqi.al |
| **Spitali Qëndror Ushtarak** | Laprakë, Tiranë<br>Tel.:04 224200 / 04 355977 / 04 325769 |
| **Qëndra Kombëtare e Mirërritjes dhe Zhvillimit të Fëmijëve** | Rruga Kombinatit, Tiranë |

### 5.3.3. Spitale private në Shqipëri

| Emri i spitalit | Adresa/ Kontakti |
|---|---|
| **Spitali "Gjerman"** | Rruga "Nikolla Lena"(Rruga e Kavajës), Tiranë<br>Tel : 04 22 74 577<br>Fax: 04 22 71 747<br>**Tel Urgjenca: 067 40 40 414**<br>**Web:**http://www.german-hospital-tirana.com<br>E-mail: info@spitaligjerman.com<br><br>The Heart Center in Albania Cardiology & Cardiac Surgery |

| | |
|---|---|
| | Tel: 04 22 58930<br>Fax: 04 22 58930<br>E-mail: heart-centre@spitaligjerman.com |
| **Spitali "Amerikan"** | Spitali Ushtarak, Laprakë, Tiranë<br>Tel: 04 235 7535 (24 hours)<br>Fax: 04 235 7634<br>Web: http://www.spitaliamerikan.com/<br>E-mail: info@spitaliamerikan.com |
| **Qendra Mjekësore Amerikane, Durrës** | L. "18", Rr. "Ahmet Ramzoti" Durrës<br>Tel: 052 222 333<br>Web: http://www.spitaliamerikan.com/<br>E-mail: info@spitaliamerikan.com<br>E-mail: vitamin@spitaliamerikan.com |
| **Qendra Mjekësore Amerikane, Fier** | L. "1 Maji", Rr. "Cameria", Përballe Spitalit, Fier<br>Tel: 034 232 121<br>Tel: 034 232-123<br>Web: http://www.spitaliamerikan.com/<br>E-mail: info@spitaliamerikan.com<br>E-mail: vitamin@spitaliamerikan.com |
